



Gjatë viteve të fundit, vendi ynë po përballet me rritje të frikshme të nivelit të vdekshmërisë që shkaktohet nga sëmundjet kronike, veçanërisht ato të zemrës, diabetit, tumoreve etj. Sipas të dhënave të raportuara nga strukturat shëndetësore të vendit tonë, vetëm nga sëmundjet kardiovaskulare çdo vit humbasin jetën mbi tetë mijë persona. Ndërkohë një në dy shqiptarë përballen me probleme serioze të zemrës.

Kundrejt kësaj situatë shqetësuese mjekët apelojnë për një kujdes të veçantë, ku një ndër mënyrat më të mira parandaluese është ajo e minimizimit të faktorëve rriskues, siç është stili i jetesës, mbajtja e një regjimi të rregullt ushqimor, shmangia e konsumit të duhanit dhe alkoolit.

Njëkohësisht çdo vit në vendin tonë evidentohen mbi 5 mijë raste të reja me tumore, pjesa dërrmuese e të cilave zbulohen në stadi tepër të rënduara, kohë në të cilën dhe trajtimi mjekësor nuk jep efektet e duhura.

Në raportin më të fundit të nxjerr edhe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë bëhet me dije se tashmë sëmundjet kronike po bëhen një burim kërcënimi vdekjeprurës, ndryshe nga sa ndodhte më parë, kur sëmundjet infektive si tuberkulozi, malaria apo HIV-AIDS-i listoheshin si sëmundjet që shkaktonin nivelin më të lartë të vdekshmërisë./albnw/